

PORTOFOLI YNË:

\$49
milion

PROJEKTET TONA:

A



furnizim i
qëndrueshëm me
energji elektrike

B



llogaridhënie dhe
transparencë

MISIONI YNË ËSHTË:

Përsheptimi i tranzicionit të Kosovës në energji të pavarur dhe qeverisje të mirë.

VIZIONI YNË ËSHTË:


Krijimi i zgjidhjeve inovative për një peizazh të qëndrueshëm të energjisë, qeverisje transparente dhe shoqëri gjithëpërfshirëse.

INFORMATA MBI PARTNERITETIN MES MFK-SË DHE TERMOKOS-IT MBI NJËHSIMIN E NGROHJES QËNDRORE

RRETH FONDACIONIT TË MILENIUMIT TË KOSOVËS

Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK) është një fondacion i pavarur i krijuar në vitin 2018 për të zbatuar Marrëveshjen e Pragut ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Korporatës së Sfidave të Mileniumit (MCC) me vlerë prej 49 milion dollarësh. Programi i Pragut i Kosovës i MCC-së adreson dy pengesa kryesore për rritjen ekonomike të Kosovës: një furnizim jo i sigurtë me energji elektrike; dhe një dobësi në sundimin e ligjit dhe në llogaridhënien dhe transparencën e qeverisë.

Investimet e MCC-së janë dedikuar për të fuqizuar sektorin e energjisë duke ulur kostot e energjisë për familjet dhe bizneset, duke rritur eficiencën e energjisë dhe duke krijuar burime të reja të gjenerimit të energjisë elektrike. Programi gjithashtu mbështetë përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për të përmirësuar vendimmarrjen dhe llogaridhënien duke rritur mundësinë për çasje në të dhëna gjyqësore, mjedisore dhe të fuqisë punëtore.



**Qeverisje transparente
dhe llogaridhënie**

Totali i projektit: **\$8,300,000**

Monitorimi dhe Vlerësimi

Totali i projektit: **\$1,700,000**

Administrimi i programit

Totali i projektit: **\$5,000,000**

**Peizazhi i Energjisë
së Qëndrueshme**

Totali i projektit: **\$34,000,000**

Njëhsimi i ngrohjes qendrore

Totali i projektit: **\$10,000,000**

NJËHSIMI I NGROHJES QËNDRORE (DHM)

HISTORIKU

Dizajni i Aktivitetit të Njëhsimit të Ngrohjes Qëndrore (DHM), i cili është një nga dy aktivitetet kryesore në kuadër të Projektit Reliable Energy Landscape (REL) (Peizazhi i Energjisë së Qëndrueshme) të Programit të Pragut, bazohet në një studim rigoroz të sistemeve të ngrohjes qendrore në Kosovë i cili tregon sfidat me të cilat përballen operatorët e ngrohjes qendrore në ruajtjen e profitabilitetit në një mjedis në tranzicion.

Në kuadër të REL, objektivi i aktivitetit DHM është të mbështesë zvogëlimin e konsumit të energjisë elektrike të përdorur për ngrohje duke zgjeruar kapacitetin në rrjetin e furnizimit me ngrohje të Termokos, në Prishtinë.

Implementimi i njëhsimit të ngrohjes qendrore në bazë të konsumit pritet të:

— UI kërkesën për ngrohje në rrjetin e ngrohjes qendrore;





— Mbështesë zgjerimin e shërbimeve të furnizimit me ngrohje për konsumatorët e ri që mbështeten në energji elektrike për ngrohje;



— Përmirësojë shërbimet për konsumatorët që tashmë banojnë në ndërtesa që shfrytëzojnë shërbimet e ngrohjes qendrore; dhe




— i mundësojë Termokosit të kalojë në faturim të bazuar në konsum dhe kështu të harmonizojë më mirë të ardhurat e tyre me kostot e tyre dhe shërbimet që ata ofrojnë.



TERMOKOSI SI PARTNER

MFK do të bashkëpunojë me Termokos, përdoruesit fundorë, Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) për të provuar modalitete dhe strategji të ndryshme për paketimin e njëhsimit të ngrohjes qendrore dhe shërbimeve të energjisë efiçente për të maksimizuar vlerën e klientit, besueshmërinë dhe efikasitetin e kostos së sektorit.



KOMPONENTËT DHE PARTNERËT E PROJEKTIT

Aktiviteti DHM përqendrohet në zbatimin e shërbimeve të njëhsimit të ngrohjes qendrore për 12.500 konsumatorë në rrjetin Termokos, përfshirë instalimin e matjes së ngrohjes me bazë të konsumit në apartamente individuale, dhe instalimin e valvulave të ngrohjes termostatike me funksion të integruar balancues në radiatorë.

Qëllimi i këtyre ndërhyrjeve është:

1

PILOTIMI I METODAVE PËR NJËHSIMIN E NGROHJES QËNDRORE NË NDËRTESAT E BANIMIT NË PRISHTINË

2

INSTALIMI I PAJISJEVE PËRKATËSE NË 12.500 APARTAMENTE DHE 60,000 RADIATORË

3

MBËSHTETJA E RREGULLATORIT ME HARTIMIN E TARIFAVE TË BAZUARA NË KONSUM

4

MBËSHTETJA E TERMOKOS NË TRANZICIONIN E AVANCIMIT NGA FATURIMI HAPËSINOR NË NJË FATURIM TË BAZUAR NË KONSUM

5

MBËSHTETJA E KONSUMATORËVE NË KONTROLLIMIN E KONSUMIT DHE KOSTOS SË FATURËS SË NGROHJES

2018

Zhvillimi i projektit me kujdes të duhur

2019

Prokurimi i shërbimeve të Konsulentit Implementues dhe Lansimi i Projektit

2020

Studime Teknike Bazë dhe Studime të Përgjithshme në Shtëpi, Tenderi për Kompaninë e Njëhsimit, Fushata vetëdijësuese

2020–2021 (2022)

Instalimi i Sistemeve të Njëhsimit, Ndhima Teknike dhe Dizajni i Tarifave të Ngrhjes, implementimi i fushatës vetëdijësuese

LAJMET E FUNDIT

NËNSHKRIMI I MEMORANDUM BASHKËPUNIMIT MES MFK DHE TERMOKOS

Në gusht, 2020, MFK dhe Termokos, furnizuesi vendor për ngrohje qendrore në Prishtinë u pajtuan të fillojnë bashkëpunimin duke nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi për implementimin e Aktivitetit të Njësisimit të Ngrohjes Qëndrore (DHM), i cili synon të mbështesë tranzicionin e ngrohjes qendrore nga faturimi i bazuar në metra katrorë në atë të faturimit të bazuar në konsum.

FILLIMI I STUDIMEVE BAZË NË NIVELIN E NDËRTIMIT PËR TË PËRGATITUR SPECIFIKIMET PËR BLERJEN DHE INSTALIMIN E SISTEMEVE TË NJËHSIMIT


Konsulenti Implementues i aktivitetit DHM, i përbërë nga një Konzorcium Gjermano-Austriak (Decon/IC), është i angazhuar në realizimin e studimeve bazë teknike të ndërtesave për blerjen dhe instalimin e sistemeve të njësisimit, si dhe anketimit. Anketimi do të përfshijë informacione për objektet e ngrohjes qendrore, sistemet hidraulike dhe të gjitha informacionet e tjera të nevojshme për të përgatitur listën për blerje.

FILLIMI I ANKETIMIT TË FAMILJEVE QË JANË KONSUMATORË TË TERMOKOS

Konsulenti Implementues i DHM do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për përgatitjen e specifikimeve teknike për prokurimin e Pajisjeve të Njësisimit. Ata do të kryejnë anketimin e familjeve në mbi 3600 apartamente, që përbën një koleksion të rëndësishëm të të dhënave për analizën e përfituesve.

FAKTE MBI PROJEKTIN DHE REZULTATET E PRITURA

Implementimi i këtij projekti fillon në qershor të vitit 2020 dhe zgjat deri në shtator të vitit 2021, me mundësi zgjatjeje 1-vjeçare.



Matësit, alokatorët e kostos së ngrohjes, valvulat dinamike termostatike dhe soft-averët fillojnë të instalohen.



MFK, MCC dhe partnerët implementues fillojnë të ofrojnë trajnime, ndërtim të kapaciteteve dhe mbështetje rregullatore.



Termokos fillon të aplikojë tarifën e reja.



Termokos përmirëson metodologjinë e faturimit dhe shërbimet ndaj klientit.



MFK, MCC dhe Partnerët Implementues fillojnë fushata intensive për ndryshimin e sjelljes, duke ndihmuar njerëzit të kuptojnë përfitimet e mundshme të sistemit të ri të faturimit.



MFK dhe MCC kryejnë monitorimin dhe vlerësimin e sistemeve në vend.



Pajtueshmëria e ndikimit në mjedis dhe social



Pajtueshmëria me përfshirjen gjinore dhe sociale